



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Data: 15.09.2023

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.728/350-45904

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM**  
**MBI LEJEN NDËRTIMORE**

Kjo leje ndërtimore për :			
Emri:	Drejtoria e Arsimit Suharekë – Drejtori Remzi Bajselmani	Nr. Personal	2000796797
Adresa:	Rr. "Brigada 123"	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore : 07Nr.350-45904, datë: 24.07.2023

Emri i Projektit:	PROJEKT KRYESOR " Objekti I ri i Sallës së Edukatës fizike ShFMU "Gjergj Kastrioti" Sallagrazhdë, Suharekë".		
Emri i Projektuesit:	"enggrup" Prishtinë		
Adresa:	Rr."Nebih Gashi" Bll6, Ob2, Kati I, Prishtinë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIMI RI			
Adresa: Rr." Brigada 123", SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	Përpjesa	Koordinatat e Objektivit-Shenimi(Piketimi)

Sipas çertifikatës me nr. të lëndës : 3860/23 datë 08.09.23, Z.K Sallagrazhë, Komuna e Suharekës.	00063-0	1: 1000	100	Y 7487495.863	X 4686352.704
			101	Y 7487514.597	X 4686351.934
			102	Y 7487513.103	X 4686315.624
			103	Y 74847494.369	X 4686315.395

<b>Lloji i ndërtimit të propozuar:</b>			
Objekt Arsimor- Objekti i ri i Sallës së Edukatës fizike ShFMU “Gjergj Kastrioti”Sallagrazhdë.			
<b>Kategoria e ndërtimeve të propozuara:</b>			
Kategoria II			
<b>Gabariti</b>	(36.34.m’ x 18.75m’)	<b>Katshmëria:</b>	(PL+0)
<b>Vija rregullative</b>	4.75 m’ nga aksi irrugës transite segmentit “Fadil Vata” Sallagrazhdë.	<b>Vija ndërtimore</b>	7.0 m’ nga vija rregulluese e rrugës transite “Fadil Vata” Sallagrazhdë.

<b>Përshkrimi i lejës ndërtimore</b>
<p>Me këtë vendim, parashtruesit të kërkesës Drejtoria e Arsimit Suharekë – drejtor Remzi Bajselmani, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e Objekti i ri i Sallës së Edukatës fizike ShFMU “Gjergj Kastrioti”Sallagrazhdë, me etazhitet PL+0 në parcelën kadastrale 00063-0, me numër referues të çertifikatës 3860/23 datë 08.09.2023, Zona Kadastrale Sallagrazhdë, Pronë e Komunës së Suharekës. Objekti në fjalë, do të shfrytëzohet si Objekti i ri i Sallës së Edukatës fizike ShFMU “Gjergj Kastrioti”Sallagrazhdë.</p> <p>Lokacioni në të cilin do të ndërtohet objekti është tokë ndërtimore me destinim sipas HZK-së (Zonë e Sherbimeve) – ZSH-4, arsim dhe hapsira sportive.</p> <p>Objekti ka gabarit (36.34m’ x 18.75m’), me katshmëri (PL+0). Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.338/350-6918, datë: 17.05.2023, si dhe projektit kryesor hartuar nga byroja projektuese: “ enggroup” Prishtinë.</p> <p>Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe bruto të objektit 681.375 m<sup>2</sup>.</p> <p>Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.</p> <p><b>Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.</li> <li>• Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Informata mbi Lejën Ndërtimore;</li> <li>- Informata mbi Projektuesin;</li> <li>- Informata mbi Kontraktuesin;</li> <li>- Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.</li> </ul> </li> <li>• Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një kopje të kësaj leje ndërtimore;</li> </ul> </li> </ul>

- Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
- Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
- Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
- Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit'
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
  - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
  - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero pjesje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

### A r s y e t i m

Aplikuesi Drejtoria e Arsimit – Drejtori Remzi Bajselmani, përmes kërkesës 07Nr.350-45904, datë: 24.07.2023, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të Objektit të ri të Sallës së Edukatës fizike ShFMU "Gjergj Kastrioti" Sallagrazhdë, sipas projektit të bashkangjitur. Në bazë të nenit 8.14 Dispozitat e veqanta të rregullorës (dispozita lehtësuese) mbi tarifat dhe ngarkesat, nuk do të paguhet taksë në këtë rast konform nenit 8.14.2 për objektet Arsimore, të rregullorës Nr-16-12102 të datës 01.12.2015, andaj edhe ky objekt lirohet nga pagesa e taksës.

Faqe 4 nga 5

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.338/350-6918, datë: 17.05.2023.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.148/23, të datës: 25.05.2023, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjetës dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.69, datë: 26.05.2023.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.268, datë: 19.06.2023.
- Pëlqim me kushte për rregullimin e dokumentacionit teknik nga KEDS, Nr.427, datë: 02.06.2023.
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-116, datë 14.09.2023.
- Koordinatat e objektit të vendosura sipas kushteve ndërtimore nga gjeodetet Komunës së Suharekës.
- Tri kopje të projektit zbatues.
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë.
- Kopje e dokumentit identifikues.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr.04/L-110, konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

*Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë*  
*Numri i vrojtimit i lejes 07Nr. 728/350-45904 datë: 15.09.2023*

Vendimi i dërgohet:

*-Parashtruesit të kërkesës;*  
*Inspektoratit të Komunës;*  
*Dosjes së DUP-së*

Drejtori i Drejtorisë:  
Visar KUÇI